

NJOFTIM
Nr. 6991, datë 14.4.2022

**PËR MARRJEN PJESË NË TRYEZËN E DISKUTIMIT DHE KËSHILLIMIT, NË
KUADËR TË PROCESIT TË INTEGRIMIT EVROPIAN, PËR KAPITULLIN 2,
“LËVIZJA E LIRË E PUNËTORËVE”**

Në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, “Për format e pjesëmarrjes, funksionimin dhe strukturën institucionale të platformës së partneritetit për integrimin evropian”;

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e institucionit drejtues të kapitullit 2, “Lëvizja e lirë e punëtorëve”, fton të marrin pjesë lirisht në Tryezën e Diskutimit dhe Këshillimit, në kuadër të procesit të integrimit evropian, e cila do të krijohet në mënyrë analoge me kapitujt e *acquis* të Bashkimit Evropian, përfaqësuesit e organizatave të shoqërisë civile, të pushtetit vendor, të komunitetit të biznesit, të shoqatave të punëmarrësve, të botës akademike, të medias dhe të grupeve të interesit, referuar përcaktimeve të kreut III.2, pika 4 të urdhrit.

Sipas përcaktimeve të kreut III.2 të urdhrit të Kryeministrit, aplikimi për t’u bërë pjesë e Tryezës së Diskutimit dhe Këshillimit kryhet nëpërmjet dorëzimit të një letre interesi, si dhe CV-së të personit apo të grupimit që përfaqëson, duke treguar se kanë ekspertizën apo interesin e mjaftueshëm për të kontribuar në tryezat specifike.

Personat apo përfaqësuesit e grupeve të interesit mund të paraqesin dokumentacionin e sipërcituar për pjesëmarrje, brenda datës 29 prill 2022, në adresat e mëposhtme elektronike të sekretariatit teknik të GNP-së, si më poshtë:

Rezarta.Dashi@financa.gov.al dhe Eva.Hamitaj@financa.gov.al.

Përzgjedhja e personave apo e përfaqësuesve të grupeve të interesit do të bëhet sipas urdhrit të Kryeministrit nr. 113, datë 30.8.2019, nga Grupi Ndërinstitucional i Punës.